

Prishtinë, 12/11/2007  
Kodi i ZRrE-së: D\_73\_2007

## **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/8 “Mbi Energjinë”;
2. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
3. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I\_05\_2007 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2007/2008”;
4. Aplikacionin për tarifatat e ngrohjes në sezonin 2007/2008 dorëzuar nga ana e Ndrohtores së Qytetit (NQ) Gjakovë SH.A. Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) më datë 10 shtator 2007;
5. Komentet për aplikacionin për tarifatat të dhëna nga ana e ZRrE-së me datë 25 shtator 2007;
6. Aplikacionin për tarifatat, të rishikuar, të NQ Gjakovë SH.A. dorëzuar me datë 28 shtator 2007;
7. Vendimin D\_71\_2007 mbi Përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara për NQ Gjakovë SH.A. për sezonin e ngrohjes 2007/2008, nxjerrë nga ana e ZRrE-së me datë 01 nëntor 2007, shoqëruar nga ANEKSI “RAPORTI RREGULLATIV – Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për NQ Gjakovë SH.A., për Sezonin e Ngrohjes 2007/2008”.
8. Propozimin e tarifave dorëzuar nga ana e NQ Gjakovë SH.A. Zyrës së Rregullatorit për Energji më 5 nëntor 2007.

### **Ka vendosur që:**

1. Të aprovojë tarifatat për NQ Gjakovë SH.A. për tërë gjashtëmujorin e sezonit të ngrohjes 2007/2008 siç është paraqitur në tabelën “A” dhe “B” dhe llogaritja detale e paraqitur në ANEKSIN e këtij vendimi “RAPORTI RREGULLATIV – Përcaktimi i Tarifave për NQ Gjakovë SH.A. për Sezonin e Ngrohjes 2007/2008”.

**TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT GJAKOVA SH.A.  
PËR SEZONIN E NGROHJES 2007/2008**

**Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT E PAMATUR**

NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVA SH.A.		
Komponentet e Tarifave	Amvisri m <sup>2</sup> për muaj	Komerical - Institucional m <sup>2</sup> për muaj
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	€ 0.18	€ 0.22
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	€ 0.67	€ 1.01

**Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT E MATUR**

NDËRMARRJA E NGROHJES QENDRORE "GJAKOVA"	
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes (komponenta fikse)	€ 1.80 / kW
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	€ 45.89 / MWh

2. Tarifat e aprovuara do të publikohen nga ana e NQ Gjakovë SH.A. në një të njërit nga gazetave kombëtare dhe lokale që qarkullojnë në Kosovë, brenda (5) ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të vendimit nga ana e ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit dhe zbatohet nga data e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së.
4. Ky vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të sundojë versioni në gjuhën shqipe.
5. NQ Gjakova ka të drejtë ankese ndaj vendimit të ZRrE-së duke dorëzuar raportin e plotë të dëshmuar brenda dhjetë (10) ditësh kalendarik pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimi të ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.

Vendimit i bashkëngjitet Raporti Rregullativ i Përcaktimit të Tarifave për NQ GJAKOVA SH.A.  
Sezoni i Ngrohjes 2007/2008.

Bordi i ZRrE-së:

---

Ali Hamiti, Kryesues

---

Theranda Beqiri, Anëtare

---

Naim Bejtullahu, Anëtar

---

Nysret Avdiu, Anëtar